

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7838
E enjte, 18 korrik 2024
Çmimi 0.50 €

Në BE vazhdojnë diskutimet për heqjen e masave ndaj Kosovës

FAQE 4



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RAMA: SULM I ORGANIZUAR PËR TA DËMTUAR TURIZMIN NË SHQIPËRI

FAQE 4-5



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se është ndërmarrë një sulm i organizuar për, siç u shpreh ai, ta goditur turizmin në Shqipëri. Kjo deklaratë, e bërë gjatë një

takimi me kryetarët e 61 bashkive në Shqipëri, vjen pasi në rrjetet sociale së fundi janë publikuar dhe shpërndarë fotografi dhe video të plazheve boshe apo

me pak pushues. Kryeministri shqiptar tha se është i pabazë pretendimi i disa ekspertëve të turizmit, se shtetasit e Kosovës e kanë 'braktisur' Shqipërinë

AKTUALE



SONDAZH: SHUMICA E AMERIKANËVE DRUAJNË NGA KAOSI NË VEND F. 2

BANKA BOTËRORE OFRON ZGJIDHJE PËR BALLKANIN PËR MENAXHIMIN E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE F. 5

KURTI TAKON DREJTORIN E ASK-SË, I SHPREH MIRËNJOHJE PËR PROCESIN E REGJISTRIMIT TË POPULLSISË F. 3

EKONOMI



"NA DUHET PËRKRAHJE", KRITERET E VËSHITURA PËR GRANTE DEKURAJONË FERMERËT F. 8

HOTI: DEKLARIMET SE ËSHTË NDALUR 'GJAKDERDHJA FINANCIARE', MASHTRIMI I RADHËS I KURTIT F. 7

SPORT



EKIPI I KHUDOS NISËT PËR PARIS

F. 10

MUSLIU: GRUPI I RADOIÇIQIT VAZHDON USHTRIMET, PO PLANIFIKON SULME F. 3



OPERIMI I HIDROCENTRALEVE TË DEÇANIT DËRGOHET NË KUSHTETUESE F. 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Sondazhi: Shumica e amerikanëve druajnë nga kaosi në vend

UASHINGTON, 17 KORRIK - Amerikanët druajnë se vendi i tyre po rrëshqet në kaos, pas përpjekjes për ta vrarë ish-presidentin Donald Trump, zbuloi një sondazh i kryer nga agjencia e lajmeve "Reuters" dhe kompania e kërkimeve "Ipsos".

Trumpi, i cili do të garojë në zgjedhjet presidenciale të nëntorit kundër presidentit aktual, Joe Biden, u plagos gjatë një tubimi në Pensilvani më 13 korrik.

Sondazhi dyditor zbuloi se ai gëzon një epërsi të lehtë në mesin e votuesve të regjistruar, me 43 për qind mbështetje, kundrejt Bidenit me 41 për qind. Por, 80 për qind e votuesve - përfshirë demokratë dhe republikanë - thanë se pajtohen me deklaratën se "vendi po del jashtë kontrollit".

Rreth 84 për qind e tyre shprehën shqetësim se ekstremistët do të kryejnë akte dhune edhe pas zgjedhjeve. Kjo shifër është në rritje nëse krahasohet me rezultatin e një sondazhi që "Reuters" dhe "Ipsos" kryen në muajin maj dhe që tregoi se 74 për qind e votuesve e kishin këtë shqetësim.

Frika nga dhuna politike në ShBA u rrit pasi disa mbështetës të Trumpit sulmuan ndërtesën e Kongresit amerikan më 6 janar të vitit 2021, në përpjekje për ta përmbysur rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2020, në të cilat Trumpi u mposht nga Bideni.

Katër persona humbën jetën në ditën e sulmit, ndërsa një oficer i policisë që luftoi kundër rebelëve vdiq të nesërmen.



Komisioni Evropian kritikohet për jotransparencë në marrëveshjet për vaksinat

STRASBURG, 17 KORRIK - Gjykata e Përgjithshme e Bashkimit Evropian tha të mërkurën se Komisioni Evropian nuk i ka ofruar publikut qasje të mjaftueshme në marrëveshjet për blerjen e vaksinave kundër koronavirusit.

Komisioni Evropian, që është krahu ekzekutiv i BE-së, ka nënshkruar disa kontrata të

mëdha me disa kompani farmaceutike në kulmin e pandemisë Covid-19, më 2020 dhe 2021.

Ligjvënësit e Parlamentit Evropian janë ankuar në gjykatën me seli në Luksemburg, se kanë kërkuar t'i shqyrtojnë kontratat për t'i kuptuar termat dhe kushtet, por se u është dhënë vetëm qasje e pjesshme.

Për më tepër, sipas tyre, disa



dokumente janë redaktuar dhe Komisioni ka thënë se kjo është bërë për t'i mbrojtur interesat

tregtare dhe procesin e vendimmarrjes.

Gjykata e Përgjithshme tha se Komisioni nuk ka dhënë prova se si qasja në disa klauzola të marrëveshjeve do ta minonte interesin tregtar të kompanive të përfshira.

Gjykata tha, po ashtu, se Komisioni ka mundur të japë më shumë informacione për

deklaratat e anëtarëve të ekipit që ka negociuar kontratat. "Komisioni nuk i ka marrë mjaftueshëm parasysh të gjitha rrethanat përkatëse për t'i peshuar drejt interesat në fjalë", tha gjykata. Vendimi i saj vjen një ditë përpara se Parlamenti Evropian të votojë për rizgjedhjen e Ursula von der Leyenit në postin e presidentes së Komisionit Evropian.

Vance paraqitet në Konventën Republikane



UASHINGTON, 17 KORRIK - I përzgjedhuri për kandidat për nënpresident të ShBA-së, J. D. Vance, u paraqit para audiencës të mërkurën, në Konventën Kombëtare Republikane.

Vance u përzgjedh këtë javë nga ish-presidenti Donald Trump për nënpresident, i cili do të garojë për një mandat të dytë në zgjedhjet presidenciale të nëntorit kundër presidentit aktual Joe Biden.

AP shkruan se ai është pak i njohur politikisht, por se "me

shpejtësi është shndërruar nga një kritik i ashpër i Trumpit, në një mbrojtës agresiv".

Trumpi, si kandidat i nominuar për president, do t'i drejtohet Konventës Republikane të enjten, në natën e fundit të saj. Pak ditë më parë ai tha se e ka rishkruar krejtësisht fjalimin e tij pas atentatit që pësoi më 13 korrik.

Në vend se ta kritikojë presidentin aktual Joe Biden, Trumpi tha se do të përçojë mesazhe uniteti.

Trumpi, 78 vjeç, u plagos në

vesh derisa fliste në një tubim në Batler të Pensilvanisë.

Sulmuesi i dyshuar i tij, Thomas Crooks, 20 vjeç, u qëllua dhe u vra nga Shërbimi Sekret, por motivi i tij mbetet i paqartë.

Nga të shtënat u vra një spektator, ndërsa dy të tjerë u plagosën rëndë. "Do të jetë një fjalim krejt ndryshe. Kjo është një mundësi për ta bashkuar vendin. Mua më është dhënë kjo mundësi", tha Trumpi duke paralajmëruar fjalimin e së enjtes.

Mbi 40 mijë të zhdukur në luftën në Ukrainë

KIEV, 17 KORRIK - Rreth 42 000 njerëz janë aktualisht të zhdukur në Ukrainë, tha të mërkurën një zyrtar i Ministrisë së Brendshme.

Dmytro Bohatiuk, i cili udhëheq Departamentin e Personave të Zhdukur të kësaj ministrie, tha se shifra përfshin ushtarë dhe civilë.

Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës në shkurt të vitit 2022.

Mijëra njerëz janë vrarë në sulme, ndërsa miliona janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre. Rreth një e pesta e Ukrainës është e pushtuar nga Rusia.

Bohatiuk tha se më herët llogariteshin mbi 51 000 të

zhdukur, por se në këtë shifër u përfshinë edhe mijëra të burgosur të luftës.

Bohatiuk tha se një sfidë tjetër për vendin është identifikimi i të vrarëve në fushëbetejë. Ai tha se Ministria e Mbrojtjes nuk merr mostra gjenetike të ushtarëve që i dërgon në terren.



Tajlanda heq vizat për shtetasit e Kosovës

PRISHTINË, 17 KORRIK - Tajlanda ka hequr vizat për shtetasit e Kosovës, ka njoftuar ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla. Në "Facebook" ajo ka thënë se "kjo arritje reflekton përkushtimin tonë të vazhdueshëm për t'i zgjeruar mundësitë ndërkombëtare dhe për t'i forcuar lidhjet

diplomatike me shtetet anembanë botës". Vendimi për vizat është fuqizuar menjëherë. Në njoftimin e Ministrisë së Jashtme është thënë se qytetarët e Kosovës do të mund të qëndrojnë pa viza në Tajlandë deri në 60 ditë brenda vitit për qëllime turizmi apo biznesi. Kryeministri i Kosovës, Albin

Kurti, ka reaguar pas përhapjes së lajmit, duke thënë se pasaporta e Kosovës po vazhdon të forcohet secilën herë e më shumë. Tajlanda është bërë vendi i fundit që ka hequr vizat për shtetasit e Kosovës. Kosovarët tani mund të udhëtojnë pa viza në 51 shtete të botës, ndërsa në 39 vende mund të pajisen me viza sapo të mbërrijnë.



Musliu: Grupi i Radoiçiqit vazhdon ushtrimet, po planifikon sulme



Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, drejtuar nga kryetarja Ganimete Musliu. Në mbledhje ka raportuar drejtori i AKI-së, Petrit Ajeti, lidhur me situatën e përgjithshme të sigurisë në vend, me fokus të veçantë në veri të vendit, si dhe aspekte të ndryshme që ndërlidhen me funksionimin e brendshëm të AKI-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 KORRIK - Kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë për Inteligjencë (AKI), Ganimete Musliu, pas raportimit të kryeshefit të AKI-

së, Petrit Ajeti, për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend, ka deklaruar se grupi paramilitar i terroristit Milan Radoiçiq është duke vazhduar ushtrimet në disa lokacione të ndryshme dhe se vazhdimisht është duke planifikuar

mundësi për sulme në Kosovë. Ajo këto deklarata i ka bërë në një konferencë për medie pas raportimit të Ajetit në Komision. "Grupi terrorist është duke kryer ushtrime në disa lokacione në rrethinën e Novi Pazarit, Kopaonikut dhe Kralevevës. Grupi paramilitar dhe terrorist i udhëhequr nga Milan Radoiçiq vazhdon të jetë i strukturuar, ka mjete të mjaftueshme financiare, ka armë dhe mbështetje nga Beogradi zyrtar. Në vazhdimësi është duke planifikuar dhe diskutuar mundësitë për sulme", ka thënë ajo. Musliu ka theksuar se kërcënimi nga Serbia për tensionim të situatës së

sigurisë në Kosovë vlerësohet të jetë i lartë dhe në forma të ndryshme, qoftë ato shtetërore apo joshtetërore. "Serbia vazhdon të ketë synime agresive ndaj Kosovës. Shërbimet sekrete të Serbisë vijojnë të kenë synim cenimin e sigurisë së Kosovës përmes mekanizmave shtetërorë dhe joshtetërore. Janë rritur aktivitetet hibride, që kanë për qëllim polarizimin e shoqërisë, përhapjen e lajmeve të rreme dhe inskenim të incidenteve. Gjendja e përgjithshme e sigurisë së Kosovës është stabile. Situata në katër komunat veriore është e qëndrueshme, edhe pse ndërhyrjet dhe përpjekjet e Serbisë për tensionim të

situatës së sigurisë janë të vazhdueshme. Kërcënimi nga Serbia dhe organizatat e ndryshme paramilitare dhe terroriste, anëtarët e të cilave po strehohen dhe po trajtohen në Serbi, vlerësohet shumë i lartë", ka pohuar ajo, duke shtuar se Radoiçiqi vazhdon bashkëpunimin e afërt me strukturat e sigurisë së Serbisë dhe me udhëheqësit e shtetit. "Gjithashtu, vazhdon të mbajë kontakte me disa grupe, organizata radikale dhe kriminale me shtrirje rajonale. Ushtria serbe ka rritur praninë e patrullave dhe dronëve në kufirin me Kosovën, sidomos nga Zubin Potoku në Leposaviç", ka thënë deputetja Musliu.

Kurti takon drejtorin e ASK-së, i shpreh mirënjohje për procesin e regjistrimit të popullsisë

PRISHTINË, 17 KORRIK - Kryeministri Albin Kurti ka takuar ushtruesin e detyrës së drejtorit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Avni Kastrati. Gjatë takimit, kryeministri Kurti shprehu mirënjohjen për Kastratin dhe ekipin e tij për procesin e suksesshëm të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare

dhe Banesave 2024. Ai theksoi se përkushtimi dhe puna e profesionale e ASK-së kanë qenë thelbësore për përballimin e sfidave dhe realizimin e këtij projekti me rëndësi kombëtare. Kryeministri e falënderoi veçanërisht për bashkëpunimin e shkëlqyer, komunikimin e vazhdueshëm dhe të hapur, si

dhe koordinimin efektiv që kanë udhëhequr këtë nismë drejt realizimit të saj. Falënderim për bashkëpunim të afërt dhe mbështetje të vazhdueshme shprehu edhe Kastrati në emër të ASK-së. Të dy shprehën bindjen se kjo frymë bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në projektet e ardhshme.





Në BE vazhdojnë diskutimet për heqjen e masave ndaj Kosovës

Zyrtarë të Bashkimit Evropian (BE) thonë se “vendimi është bërë më i vështirë pas sjelljes jokonstruktive” në takimet e fundit në mes të Kosovës dhe Serbisë në nivel të lartë dhe në nivel të kryenegociatorëve. Verën e kaluar BE-ja ka ndërmarrë disa masa ndëshkuese kundër Kosovës, përfshirë anulimin e disa takimeve në nivel të lartë, duke vlerësuar se Kosova nuk ka ndërmarrë hapa të mjaftueshëm për shtensionimin e situatës në veriun e banuar me shumicë serbe

PRISHTINË, 17 KORRIK - Përkundër pritjeve dhe paralajmërimeve se masat e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës do të hiqen, së paku gradualisht, kjo nuk ka ndodhur ende. Verën e kaluar BE-ja ka ndërmarrë disa masa ndëshkuese kundër Kosovës, përfshirë anulimin e disa takimeve në nivel të lartë, duke vlerësuar se Kosova nuk ka ndërmarrë hapa të mjaftueshëm për shtensionimin e situatës në veriun e banuar me shumicë

serbe. Tensionet në këtë zonë janë rritur pasi Qeveria e Kosovës ka instaluar kryetarët shqiptarë në komunat me shumicë serbe në fund të majit të vitit 2023. Rekomandimin për heqjen e masave e ka dhënë në qershor përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, duke e arsyetuar atë me hapat që ka marrë Kosova për përmbushjen e kushteve për heqjen e tyre. Tani thuhet se Shërbimi i Veprimt të Jashtëm të BE-së

(EEAS) është duke i vazhduar konsultimet me vendet anëtare për tekstin e një deklarate të përfaqësuesit të lartë me të cilën do të njoftohej për heqjen e masave. Por, disa versione të tekstit të një deklarate të tillë nuk kanë arritur ta marrin mbështetjen e të gjitha vendeve anëtare. Sipas burimeve diplomatike në BE, shumica e vendeve janë pajtuar të hiqen masat, disa kanë dashur të hiqet vetëm një pjesë e tyre, por disa kanë kërkuar edhe vendosjen e një klauzole, sipas së cilës, masat do të mund të ktheheshin me automatizëm nëse autoritetet e Kosovës do të ndërmerrnin ndonjë hap të njëanshëm dhe të pakoordinuar në veri, që do t'i rriste tensionet. Zëdhënësi i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Peter Stano, tha për Radion Evropë e Lirë se Borrelli, ashtu siç është kërkuar prej tij, ua ka dërguar raportin vendeve anëtare dhe diskutimi për të është zhvilluar në qershor. Por, Stano tha se “përmbajtja e atij raporti nuk do të bëhet publike”. Radio Evropë e Lirë ka pasur

rast ta shohë atë raport dhe në të është rekomanduar heqja e masave. “Marrë parasysh hapat që i ka ndërmarrë Kosova drejt përmbushjes së kërkesave të BE-së, të shprehura në deklaratën e 3 qershorit 2023, përfaqësuesi i lartë i rekomandon Këshillit [Evropian] të marrë qëndrim për heqjen e masave për Kosovën, në të njëjtën kohë duke respektuar prerogativat institucionale”, është thënë në raportin e Borrellit. Borrelli, në rekomandimin e tij, ka thënë se vendimi nga ana e Këshillit do të kontribuonte në një kontekst të balancuar, në të cilin dialogu për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Prishtinës dhe Beogradit, i lehtësuar nga BE-ja, do të mund të ecë përpara. “Nga Kosova pritet ta shfrytëzojë këtë mundësi për të vepruar në mënyrë depërshkallëzuese dhe për t'i evituar veprimet e pakoordinuara”, është thënë në raportin e Borrellit. Por, gjatë diskutimeve, disa vende anëtare kanë argumentuar se përmbushja e kushteve nga ana e Kosovës “nuk është e

plotë”. Stano thotë se “diskutimet në Këshill po vazhdojnë”. Në Bashkimin Evropian nuk duan të flasin për afatet kohore se kur do të mund të hiqeshin masat, por zyrtarë të BE-së - në kushte anonimiteti - thonë se “vendimi është bërë më i vështirë pas sjelljes jokonstruktive” në takimet e fundit mes Kosovës dhe Serbisë, në nivel të lartë dhe në nivel të kryenegociatorëve. Në fund të qershorit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, janë ftuar në Bruksel për një raund të ri bisedimesh, por takimi i përbashkët nuk është zhvilluar për shkak të disa kushteve që ka nxjerrë Kurti e që i ka refuzuar Vučići. Disa burime të BE-së thonë se në mesin e arsyeve përse disa shtete nuk duan të hiqen masat janë niveli i ulët i besimit ndaj autoriteteve të Kosovës dhe frika se Kosova mund të ndërmarrë hapa të njëanshëm për hapjen e urës mbi lumin Ibër, që lidh veriun dhe jugun e Mitrovicës.

Banka Botërore ofron zgjidhje për Ballkanin për menaxhimin e ndryshimeve klimatike

PRISHTINË, 17 KORRIK - Gjashtë ekonomistë e Ballkanit Perëndimor duhet të investojnë kolektivisht të paktën 37 miliardë dollarë gjatë dekadës së ardhshme për t'i mbrojtur në mënyrë efektive njerëzit dhe pronat nga ndikimet e dëmshme dhe përshkallëzuese të ndryshimeve klimatike, thuhet në raportin rajonal të Grupit të Bankës Botërore për Klimën dhe Zhvillimin e Vendit për Ballkanin Perëndimor (CCDR), i publikuar të mërkurën.

Përfitimet nga veprimet efektive të klimës do të ishin të mëdha për Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë Kosovën, Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Këto investime do të ndihmonin në shmangien e humbjeve të jetës së njerëzve, të pronave, produktivitetit dhe do të ndihmonin në përshtetimin e rritjes ekonomike.

Banka Botërore deklaroi se mosveprimi nuk është një opsion për rajonin, i cili tashmë është ndikuar rëndë nga ndryshimet klimatike. "Për shembull, përmblytjet kanë prekur drejtpërdrejt dy milionë njerëz në dekadën e fundit, me ndikimet që do të përkeqësohen me reshje më ekstreme. Zjarret janë një kërcënim në rritje, me mbi 1 500 të regjistruara në vitin 2021, një rritje prej 21 % gjatë dekadës së fundit. Thatësirat po ndikojnë negativisht në prodhimin bujqësor, ndërsa valët e të nxehtit po kontribuojnë



në ndotjen e ajrit, duke shkaktuar mijëra vdekje të parakohshme çdo vit në Ballkanin Perëndimor", thuhet në raport.

Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, investimet për përshtetjen ndaj ndryshimeve klimatike, veçanërisht në ekonomitë me të ardhura të ulëta dhe të mesme, sjellin përfitim të konsiderueshme, me rreth 4 dollarë përfitim për çdo një dollar të investuar. "Vendet në Ballkanin Perëndimor gjithashtu duhet t'i reduktojnë emetimet e tyre të gazeve serrë për të qenë edhe tuftë konkurrues, për ta forcuar sigurinë energjetike dhe për të tërhequr

investime ndërkombëtare. Megjithatë, arritja e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050, në përputhje me objektivat e Bashkimit Evropian, do të kërkonte investime shtesë prej 32 miliardë dollarësh. Arritja e emetimeve neto në nivelin zero të gazrave serrë në të gjithë ekonominë deri në vitin 2050 është e realizueshme nëse energjia diellore, era dhe hidrocentrale mund të gjenerojnë mbi 95 për qind të prodhimit total të energjisë, një rritje e konsiderueshme nga një e treta e gjenerimit aktual", thuhet në raport.

Përveç kësaj, dekarbonizimi i

sektorit të ndërtesave nëpërmjet investimeve për eficientë e energjisë është thelbësor. Për më tepër, sektori i transportit duhet të transformohet ndjeshëm duke reduktuar kërkesën për automjete, duke kaluar në mënyra më të qëndrueshme transporti dhe duke kaluar në automjete elektrike. Raporti thekson se një pjesë e konsiderueshme e financimit mund të vijë nga sektori privat. Megjithatë, për t'i mobilizuar investimet private, vendet në Ballkanin Perëndimor duhet të sigurojnë mjedise të qëndrueshme dhe tregje financiare tërheqëse për t'i

inkurajuar kompanitë që të përfshihen në mundësitë e paraqitura nga tranzicioni.

CCDR-ja e Ballkanit Perëndimor ka disa politika për ta dërguar rajonin drejt neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Këto rekomandime janë të organizuara në tre kategori politikash:

Të ndërthurura: Integrimi i përpjekjeve të përshtatjes dhe zbutjes nëpër institucione është i nevojshëm për veprim efektiv ndaj ndryshimeve klimatike. Për shembull, agjencitë ose komisionet e specializuara të fokusuara në klimën duhet të krijohen dhe angazhimet kombëtare për ndryshimin e klimës duhet të shërbejnë si një kapacitet këshillues për të gjitha çështjet që lidhen me klimën.

Ndërkufitare: Bashkëpunimi ndërkufitar është thelbësor për trajtimin e rreziqeve klimatike që tejkalojnë kufijtë gjeografikë. Forcimi i institucioneve rajonale është kyç për ta mundësuar koordinimin në fusha si sistemet e paralajmërimit të hershëm, menaxhimi i përbashkët i burimeve ose sistemet e harmonizuara të energjisë.

Synimi: Adresimi i nevojave specifike të komuniteteve që janë më të cenueshme është thelbësor për zgjidhje efektive dhe zbatimin e politikave. Politikat e synuara përfshijnë reformat e arsimit dhe trajnimit për ta rritur lëvizshmërinë e fuqisë punëtore dhe përpjekjet për të zbatuar praktika për klimën.

Rama: Sulm i organizuar për ta dëmtuar turizmin në Shqipëri

TRANË, 17 KORRIK - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se është ndërmarrë një sulm i organizuar për, siç u shpreh ai, ta goditur turizmin në shtetin e tij. Kjo deklaratë, e bërë gjatë një takimi me kryetarët e 61 bashkive në Shqipëri, vjen pasi në rrjetet sociale së fundi janë publikuar dhe shpërndarë fotografi dhe video të plazheve boshe apo me pak pushues në Shqipëri. "Të jeni të vetëdijshëm se ka sulm të organizuar për ta dëmtuar turizmin shqiptar. Kam folur me krerët e bashkive bregdetare që janë të habitur nga shumë video, lajme e komente të rreme, të manipuluar, të bëra me qëllim që duan të thonë se këtu s'ka ardhur njeri. Sulmi vjen nga disa anë. Sistemet tona të sigurisë kanë ndezur dritën e kuqe, të sigurisë kibernetike. Ka shumë profile false që përdoren për këtë sulm", ka deklaruar Rama më 17 korrik.

Sipas Ramës, Shoqata Evropiane e Udhëtimeve, sipas klasifikimit të fundit, e ka renditur Shqipërinë në vendin e parë me 86 për qind rritje të fluksit të



udhëtimeve. Shqipëria pasohet nga Serbia me 48 për qind, Mali i Zi dhe Turqia.

Kryeministri shqiptar tha se është i pabazë pretendimi i disa ekspertëve të turizmit se shtetasit e Kosovës e kanë 'braktisur' Shqipërinë. "Nga janari në qershor janë 1.7 milion hyrje të

qytetarëve të Kosovës ose 25 për qind më shumë se vjet", tha Rama. Megjithatë, ai e pranoi se sektori i turizmit ka disa problematika për të cilat kryeministri shqiptar kërkoi të merren masa për t'u adresuar në kohë.

Kryeministri iu drejtua

kryebashkiakëve të Vlorës dhe Sarandës, ku janë raportuar çmime të larta krahasuar me një vit më parë, duke kërkuar që ata të bisedojnë me operatorët turistikë për këtë problematikë. "Duhet t'u thuhet që kjo është jo vetëm e padrejtë, por është strategjikisht vetëvrasje për ata

vetë", tha Rama gjatë takimit.

Ai tha se kjo ka ndodhur për shkak se turistët e huaj e konsideruan Shqipërinë një destinacion të lirë, por shtoi se kjo do t'i dëmtojë këta operatorë turistikë, kryesisht në jug të Shqipërisë, por edhe gjithë turizmin.

Një tjetër çështje që e cilësoi shqetësim për turizmin është ndotja. Rama tha se ka përmirësim krahasuar me një vit më parë, por sërish ndotja mbetet problematike. Shembull ai mori Liqenin e Komanit në veri të Shqipërisë. "Liqeni i Komanit pastrohet çdo dy javë. Do ta çojmë edhe ushtrinë për ta pastruar, por kjo histori që banorët hidh dhe ushtria pastro, s'mund të vazhdojë", tha ai.

Sipas të dhënave të fundit të publikuara nga qeveria shqiptare, nga janari i këtij viti deri në qershor vendin e kanë vizituar 4.5 milionë turistë ose 34 për qind më shumë se në të njëjtën periudhë se një vit më parë. Ndërkaq, më 2023 Shqipëria regjistroi një numër rekord turistësh prej 10.1 milionësh.

Mundësi transferimi në UP për stafin akademik që punon në universitetet më të mira botërore

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 KORRIK - Me miratimin e Statutit të ri të Universitetit të Prishtinës, është hapur, për herë të parë, mundësia për transferimin në UP të anëtarëve të personelit akademik që janë në marrëdhënie të rregullt pune në cilindo nga top 400 universitetet më të mira të botës.

Sipas nenit 151(1) të statutit: "Personeli akademik që është në marrëdhënie të rregullt pune në një universitet që është në mesin e katërqind (400) universiteteve më të mira në botë, sipas renditjes së bërë nga 'Times Higher Education World University Rankings' ose 'QS World University Rankings', ka të drejtë transferimi në universitet pa iu nënshtruar procedurave të konkursit publik."

Sipas statutit, "kërkesa për transferim bëhet me propozimin e rektorit, dekanit ose këshillit të njësisë akademike përkatëse dhe miratohet nga senati".

Në këtë rast, kandidatët e

interesuar, që e plotësojnë kriterin e mësipërm, mund ta shprehin interesin te cilido prej këtyre autoriteteve, pra rektori, dekani ose këshilli i fakultetit përkatës.

Kjo është një masë e re institucionale, që synon ta hapë universitetin dhe t'i zgjerojë mundësitë për ta tërhequr kuadrin më të përgatitur, cilësor dhe konkurrues akademik kudo që ai është, me synim të veçantë shkencëtarët e studiuesit nga diaspora.

Statuti, po ashtu, parasheh për herë të parë mundësinë e zgjedhjes së personelit akademik në formatin e programit për "kthimin e trurit" ("brain gain").

Detajet procedurale të procesit do të përcaktohen së shpejti, sipas kërkesës së statutit, përmes një rregulloreje të veçantë të senatit, përpara shpalljes së thirrjes publike. Qëllimi i këtij programi është rekrutimi i kuadrin të talentuar dhe ndërkombëtarisht konkurrues, që ka kryer së paku një apo më tepër nivele studimi jashtë vendit.



Veprimet e këtilla i mundësojnë UP-së për t'u konsoliduar si institucion udhëheqës në arsimin e lartë në Kosovë e në rajon, për ta

ngritur e zgjeruar profilin akademik dhe pozicionin institucional në planin ndërkombëtar, si dhe për të pasur

një status dinjitoz në rrethin e partnerëve nga e mbarë bota, që tërheq dhe afron mendjet më të ditura e më të ndritura.

Turizmi në Shqipëri u rrit për 86 për qind



TIRANË, 17 KORRIK - Shqipëria renditet e para në rritjen e turizmit, duke lënë pas vende të tjera si Greqia. Përqindja e rritjes së turizmit në Shqipëri është 86 për qind, ndërsa Greqia e ka rritjen 25 për qind në krahasim me vitin 2019. Sigurisht numri i turistëve në Greqi është shumë herë më i madh.

Të dhënat e raportit të Komisionit Evropian tregojnë se vende të vogla si Shqipëria dhe Mali i Zi kanë parë rritjen më të fortë të tregut në 6 muajt e parë të vitit 2024.

Komisioni Evropian për udhëtimet thotë se Shqipëria është tërheqëse për turistët e huaj, teksa kohën e fundit është shfaqur një tendencë rritëse e vizitorëve aziatikë.

Sipas raportit, aktiviteti turistik në Evropë ka ndjekur kryesisht një prije të ngjashme gjatë dy tremujorëve të parë të vitit 2024. Udhëtimet ndërkombëtare kanë ardhur në rritje në të gjithë kontinentin krahasuar me vitin e kaluar. Krahasuar me nivelet para pandemisë, rritjet janë përkatësisht 6% dhe 7%.

Destinacionet e Evropës Jugore,

përfshirë edhe Shqipërinë, kanë nxitur rritjen e turizmit evropian dhe mbeten vazhdimisht të preferuara për kushtet e favorshme klimatike në prag të sezonit të verës si dhe për kostot e përballeshme.

Në vitin 2024 kostot operacionale për bizneset turistike dhe, rrjedhimisht, kostot e udhëtimit për konsumatorët, mbeten një nga temat më të spikatura për industrinë globale. Përveç kësaj, tërheqja e vlerës për paranë në destinacionet jotradicionale, së bashku me kthimin e udhëtarëve nga Azia-Paqësori, dhe disponueshmëria në rritje e udhëtimeve hekurudhore, po formësojnë gjithnjë e më shumë peizazhin turistik të Evropës.

Raporti i Komisionit Evropian, që rendit në krye Shqipërinë, konfirmon trendin rritës që vendi ynë ka marrë prej disa vitesh në turizëm.

Viti 2023 u mbyll me 10 milionë vizitorë, ndërsa parashikimet flasin për një rritje edhe gjatë vitit 2024.

Nënshkruhet memorandumi për rindërtimin e 114 zonave kadastrale për 32 komuna të Kosovës

PRISHTINË, 17 KORRIK - Ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka bërë me dije se kanë nënshkruar memorandumin për rindërtimin e 114 zonave kadastrale për 32 komuna të Kosovës. "Pas miratimit të Ligjit për Kadastër, si dhe pas hartimit dhe nënshkrimit të një sërë pakosh të udhëzimeve administrative, sot kemi hapur një etapë të re për rindërtimin e kadastrës, rrjedhimisht rregullimin e sistemit të adresave, si dhe ndërlikjes

së sistemit të adresave për të gjithë qytetarët", ka thënë Aliu.

Ai ka thënë se këto projekte janë jashtëzakonisht të rëndësishme për vendin tonë dhe do të mund të realizohen në bashkëpunim të ngushtë në mes të nivelit qendror, ministrisë, komunave, Agjencisë Kadastrale dhe të gjitha drejtorive që kanë të bëjnë me pronat. "Njëherësh përmes projektit të RK-së do të incizohen edhe objektet pa leje, të cilat do t'u

kursejnë qytetarëve një shumë të majme për matjet gjeodezike të tyre, po ashtu do ta lehtësojë legalizimin e objekteve. Tashmë jemi angazhuar maksimalisht për realizimin e projektit të rindërtimit të informacioneve kadastrale të cilat do të përfshijnë 114 zona kadastrale. Përfitues të drejtpërdrejtë nga ky projekt do të jenë qytetarët e zonave kadastrale në të gjitha komunat e vendit", ka thënë ministri Aliu.



Komisioni për Integritet Evropian miraton Projektligjin për krypto-asetet

Prishtinë, 17 korrik - Komisioni për Integritet Evropian, kryesuar nga kryetarja Rrezarta Krasniqi, mbajti të mërkurën mbledhjen e radhës, në të cilën

shqyrtoi Projektligjin për krypto-asetet, amendamentet e komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me

legjislacionin e BE-së. Lidhur me këtë projektligj, përkatësisht qëllimin dhe fushën që ai mbulon, dha sqarime deputeti Driton

Hyseni. Projektligji u hodh në votim, dhe kryetarja e komisionit konstatoi se Projektligji për krypto-asetet u përkrah nga komisioni.



Operimi i hidrocentraleve të Deçanit dërgohet në Kushtetuese

PRISHTINË, 17 KORRIK - Çështja e operimit të hidrocentraleve në rrjedhën e Lumëbardhit në komunën e Deçanit ka shkuar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Organizatat Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Pishtarët dhe disa qytetarë të Deçanit kanë dërguar në Kushtetuese kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së një aktgjykimi të Gjykatës Supreme të datës 5 mars 2024. Nëpërmjet këtij aktgjykimi ishin vlerësuar të ligjshme procedurat dhe vendimet për dhënien e lejeve ujore dhe mjedisore për Hidrocentralet "Belaja", "Deçani" dhe "Lumëbardhi 2". Këto organizata dhe një grup i qytetarëve nga Deçani vlerësojnë se Aktgjykimi i Supremes është në kundërshtim me disa nene të Kushtetutës së Kosovës. Përfaqësuesit e këtyre organizatave vlerësojnë se në vendimet e mëparshme, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës kanë bërë interpretime të gabuara të Ligjit për Ujërat, si dhe pretendojnë se janë

shpërfillur dëmet mjedisore. Dëmet mjedisore të shkaktuara nga ndërtimi i këtyre hidrocentraleve në rrjedhën e Lumëbardhit ishin konstatuar edhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Kosovës (MMPH). Operimi i këtyre hidrocentraleve ishte pezulluar në disa raste herë me vendim të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, herëve të tjera me vendim të gjykatave. Në vendimin e fundit të Gjykatës Supreme u tha se kjo gjykatë nuk ka kompetencë të veprojë kundrejt mosveprimin të MMPH-së për t'i ndaluar dëmet mjedisore. Në vitin 2021 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kishte publikuar një koncept për rehabilitim e dëmeve mjedisore të shkaktuara në grykën e Deçanit. Por, mënyra se si ishte paraparë të bëhej rehabilitimi ishte kundërshtuar nga aktivistë mjedisorë dhe nga një prej organizatave më të mëdha në Evropë që lufton për mbrojtjen e lumenjve nga shkatërrimi,



"Riverwatch".

Në rrjedhën Lumëbardhit në këtë qytet janë katër hidrocentrale në pronësi të kompanisë austriake "Kelkos". Që nga fillimi i ndërtimit të hidrocentraleve, në vitin 2014,

aktivistët dhe banorët lokalë kanë ngritur zërin për dëmet që i janë shkaktuar lumit dhe zonës përreth. Ata thonë se "Kelkos"-i gjatë punimeve ka dëmtuar shtratin e lumit dhe pjesët atraktive për turizëm.

"Kelkos", po ashtu, është akuzuar se shfrytëzon sasi më të madhe të ujit për prodhim të energjisë elektrike sesa sasia që e ka të lejuar, duke e lënë lumin pa ujë në pjesën më të madhe të vitit. (Rel)

Hoti: Deklarimet se është ndalur 'gjakderdhja financiare', mashtrimi i radhës i Kurtit



PRISHTINË, 17 KORRIK - Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se deklarimet se është ndalur "gjakderdhja financiare" dhe janë mbyllur "vrmat e buxhetit" është mashtrimi i radhës i Kurtit dhe LV-Guxo. "Sipas raportit të buxhetit për 2023 (faqe 29), për vitet 2021-2023 janë paguar 520 milionë euro për entitete publike (102 mil në 2021, 233 mil në 2022 dhe 185 mil në 2023). Kurrë nuk janë shpenzuar kaq shumë mjete për ndërmarrjet publike. Me gjithë këto mjete do të mund të ndërtohej një bllok i ri energjetik në KEK, centrali me gaz, apo të përmbylej projekti madhor i Ibër-Lepencit, për të cilin është iniciuar master plani në qeverinë paraprake", ka shkruar Hoti në "Facebook". Ai ka shtuar se disa herë ka bërë

pyetje parlamentare në Kuvend, me shkrim dhe me gojë, për të parë listën e plotë të subvencioneve për ndërmarrjet publike. "As ministri i Financave që është përgjegjës për buxhetin, e as Ministria e Ekonomisë përgjegjës për ndërmarrjet publike, nuk kanë kthyer përgjigje. Këta do të mbahen përgjegjës për këto abuzime me buxhetin, herët a vonë. Këta gjithmonë nuk do të jenë në pushtet për të pamundësuar qasjen e deputetit në mënyrën si shpenzohen taksat e kosovarëve. Auditori duhet me kujdes të analizojë këtë rrjedhje masive të buxhetit të shtetit. Këto dhe çështje të tjera sot do të diskutojmë në Komisionin për Buxhet me Ministrin e Financave", ka thënë deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti.

Krasniqi pret në takim deputetin kanadez, dhëndër i Kosovës

PRISHTINË, 17 KORRIK - Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka pritur në selinë e PDK-së deputetin kanadez, që tashmë është bërë dhëndër i Kosovës, Kyle Seeback, si dhe

bashkëshorten e tij, Fluturën. "Me Kyle, i cili është anëtar i Grupit të Miqësisë me Kosovën, si dhe Ministër në Hije për Tregti Ndërkombëtare, diskutuam

për raportet mes dy shteteve tona dhe mundësitë e fuqizimit të këtyre raporteve. Kanada në përgjithësi, e Kyle në veçanti, janë krah i

rëndësishëm i mbështetjes ndaj shtetit dhe popullit tonë. Faleminderit për vizitën, Kyle dhe Flutura!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



“Na duhet përkrahje”, kriteret e vështira për grante dekurajojnë fermerët



PRISHTINË, 17 KORRIK - Ora pesë e gjysmë e mëngjesit rëndom e gjen Valdete Sahitin në serrë. Brenda saj ajo ka mbjellë tranguj të vegjël që përdoren për turshi. “Në ora shtatë e gjysmë nuk mund të rrihy aty (nga i nxehti)”, thotë Sahiti duke shpjeguar pse puna në serrë duhet të kryhet herët.

Vjelja e trangujve përbën vetëm fillimin e punës së përditshme për këtë fermere në Skifteraj të komunës së Vitisë, e cila kultivon perime si lëndë të parë, të cilat më pas i përpunon si turshi dhe i shet në treg.

Valdetja, me profesion ekonomiste, thotë se nuk ishte e punësuar për rreth 15 vjet pas martesës teksa kujdesej për katër fëmijët e saj. Ajo nisi të merret me bujqësi rreth vitit 2015, fillimisht si pjesë e një shoqate të grave të rrethit. “Për këtë veprimtari më herët nuk kam pasur njohuri aspak, mirëpo këtu (në Viti) e kam parë që është një tokë shumë pjellore, shumë e mirë”, rrëfen ajo. Që nga viti 2022 Sahiti e regjistroi biznesin e saj të quajtur “Loel” dhe tani produktet e turshive dhe ajvarit i shiten në disa markete në zonën e Gjilanit.

Duke u rritur interesimi për produktet e saj, Sahiti thotë se vazhdimisht i duhet përkrahje për pajisje si dhe shtim i hapësirës për ta rritur prodhimin.

Tani për tani ajo së bashku me dy punëtore prodhojnë produktet në bodrumin e shtëpisë së saj, të cilin ndër vite e ka adaptuar përmes granteve nga organizatat e huaja. “Jemi shumë ngushtë, e kam një pajisje që ende nuk kam mundur ta fus në përdorim për shkak të hapësirës”, thotë ajo.

Dyzetegjashtëvjeçarja thotë se është interesuar shpesh për të aplikuar për grante qeveritare, në veçanti nga Ministria e Bujqësisë,

por thotë se është dekurajuar nga kriteret që në disa raste është edhe pasja në pronësi e tokës që e punon. “Tokë është e familjarëve, nuk është as në emrin tim, as në emër të burrit, por në emër të gjyshit të burrit. Pak problem po na sjell, por jemi në procedurë duke i rregulluar dokumentet”, tregon ajo.

Kriteri i të qenët pronar i tokës për të marrë disa lloje të granteve nga Ministria e Bujqësisë është kritikuar edhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në një raport të vitit 2024. Ky raport ka analizuar masat e ndërmarra nga institucionet për punësimin e grave në zonat rurale.

Në veçanti ata kanë analizuar procesin e shpërndarjes së granteve nga Ministria e Bujqësisë për bujqit dhe, në këtë rast, grave që merren me bujqësi. Kjo ministri ndër vite ka aplikuar ato që quhen masa afirmative, duke dhënë pikë shtesë për gratë që aplikojnë për grante. Por, sipas ZKA-së, këto masa nuk patën efektin e vet për shkak se u kushtëzuan me kriteret si ajo për pronësinë e tokës, apo edhe kohëzgjatjes së pronësisë së biznesit për të paktën tre vjet. “Gratë në gjithë Kosovën gëzojnë pronësinë e paluajtshme në vetëm 17 për qind të pronave dhe për tokat bujqësore kjo përqindje mezi arrin në 4, prandaj kushtëzimi i masës me pronën e paluajtshme ka përjashtuar shumë më tepër gra se burra”, thuhet në raportin e Auditorit. “Unë nuk e përjashtoj këtë (kriter) që duhet ta kesh tokën në emër tëndin. Është kriter i mirë, por nuk është realist”, thotë Valdetja duke theksuar se shumica e grave që njeh, nuk kanë tokë në pronësi. Shumica e grave në Kosovë nuk trashëgojnë prona nga prindërit

njësoj si burrat, ndërsa pasuria pas martesës shpesh nuk regjistrohet në emër të përbashkët të të dy bashkëshortëve. Kundër këtij fenomeni ka vite që avokon Habibe Haxhimustafa nga komuna e Rahovecit, e cila udhëheq shoqatën “Gruaja Fermere”. “Në komunën tonë është faktike. Gratë punojnë shumë në bujqësi, por nuk janë të regjistruara. Ose punojnë bashkë me bashkëshortin ose nëse e udhëheqin biznesin nuk e regjistrojnë në emër të vet. Edhe në emër të djalit e regjistrojnë shpesh”, thotë Haxhimustafa.

Qeveria e Kosovës në vitin 2016 kishte hartuar një udhëzim administrativ, i cili i obligon bashkëshortët që pronën e blerë së bashku, ta regjistrojnë në emër të të dyve, përveç nëse ndonjëri heq dorë në mënyrë vullnetare. Për stimulim, qeveria ka paraparë edhe që regjistrimi i pronës të përbashkët të bëhet falas. Sipas Haxhimustafës, kjo masë stimuloese “ka ndikuar shumë pak”. Ndërsa sipas Agjencisë Kadastrale të Kosovës, që nga koha kur ky udhëzim ka hyrë në fuqi, numri i pronave të regjistruara në emër të grave është rritur për rreth 4 për qind.

“100 dokumente t’i kërkojnë dhe në fund nuk fiton”

Specia, tranguj e majdanos i freskët janë renditur në tezgën e shitjes së Raza Demollit, që më 10 korrik ishte vendosur në sheshin “Bill Clinton” në Prishtinë. Demolli, që thotë se merret me bujqësi prej më shumë se 20 vjetësh, është shitëse e rregullt në tregun mobil, i cili organizohet tri ditë të javës në tri lokacione të

kryeqytetit. Në këtë treg shiten kryesisht produkte bujqësore dhe punëdore nga shitës që vijnë nga zona të ndryshme të Kosovës.

Demolli tregon se serrat ku i ka mbjellë perimet që po i shiste, gjenden rreth 35 kilometra larg Prishtinës, në fshatin Gillogicë. “(Së bashku me familjen) ikemi tri serra dhe 50 arë fushë të hapur. Nuk është lehtë aspak nëse nuk i ke mjetet, e nëse i ke (mjetet) edhe për një grua nuk është punë e vështirë nëse e do punën”, tregon Demolli.

Pikërisht për të kërkuar mjete shtesë apo më të reja të punës, Raza thotë se interesohet shpesh për të aplikuar për grante, jo vetëm te Ministria e Bujqësisë. “Është zor boll se 100 dokumente t’i kërkojnë, krejt ato do t’i kompletosh dhe në fund nuk ta pranojnë. Në fund nuk e fiton”, thotë ajo. Sipas Demollit, kriteret për fitimin e granteve shpesh janë specifike dhe shpesh vështirë të arritshme. “Ndoshta dikujt i ndihmojnë, por mua jo. Unë kam dëshirë të më vizitojnë një herë, të shihet se çfarë punoj. Na duhet përkrahje”, thotë Demolli.

Në raportin e ZKA-së kritikohet edhe një kriter tjetër që kërkohet për grante e që ka të bëjë me moshën e fermerëve, ku kanë përparësi të rinjtë. “Meqenëse në Kosovë moshë e grave që merren me bujqësi është kryesisht 45-55 vjeç, përfitimi i pikëve si fermer i ri ka stimuluar moshat e reja, por ka përjashtuar gratë fermere”, thuhet në raport.

Ministria e Bujqësisë nuk u është përgjigjur pyetjeve të Radios Evropa e Lirë në lidhje me gjetjet e Auditorit, veçse ka dhënë qasje në shifrat e granteve dhe subvencioneve (pagesave direkte) të dhëna ndër vite për gra dhe burra.

“Të paktën të paguhet mundi”

Në lindje të Kosovës, në qytetin e Kamenicës, punës në bujqësi i është përveshur edhe Rufadije Shillova. Shillova thotë se vendosi që në tokën prej rreth 10 arësh, që e ka ngjitur me shtëpinë, të nisë mbjelljen e mjedrave, tre vjet më parë.

Duke qenë se ka të kryer vetëm shkollën fillore, për Rufadijen, biznesi me mjedra është mundësia e vetme për të ardhura financiare për të, pasi thotë se e ka vështirë të gjejë tjetër vend pune. Ajo thotë se e ka pasur përkrahjen edhe të burrit të fëmijëve, por është dekurajuar për shkak të mungesës së përkrahjes shtetërore dhe për shkak se aktualisht shitja e mjedrave nuk është e leverdishme. “Çmimi i mjedrave ka rënë shumë në treg. Nuk po paguhet munda. Po më rrjedhin djersët. Në pikë të vapës po i ujis”, tregon ajo.

Rufadija, 51-vjeçare, thotë se është dekurajuar të aplikojë për grante, pasi zakonisht kërkohet që një pjesë të financimit të projektit ta bëjnë edhe vetë. “Po kërkojnë shumë. Kërkojnë të japim edhe ne (para)”, thotë ajo.

Rufadija ka frikë se mungesa e leverdisë nga puna bujqësore do t’i ftohë djemtë e saj adoleshentë nga “dashuria që kanë për vendlindjen dhe shtëpinë e tyre”. “Ata mund të kërkojnë të largohemi (nga Kosova)”, thotë ajo.

E zhgënjyer nga vështirësitë për ta zhvilluar biznesin në fshat thotë se ndihet shpesh edhe Valdete Sahiti. “Nganjëherë më shkoll mendja të tërhiqem, por prapë e kam atë inatin (sepse) llogaris se çfarë të bëj tërë ditën, pasi nuk kam një vend tjetër të punës”, thotë ajo.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Portieri i Kosovës transferohet në Ipswich

IPSWICH, 17 KORRIK - Portieri i Kosovës, Arijanet Muriq, ka nënshkruar kontratë me skuadrën e Premierligës, Ipswich Town. Pas rënies të Burnleyt nga elita, 25-

vjeçari ka mbetur në kampionatin anglez duke iu bashkuar rivalit në një marrëveshje që ka kushtuar 8 milionë euro, por mund të rritet në 10

milionë euro shkakut i bonuseve. Muriq që sezonin e kaluar deri në 10 xhirot e fundit ishte vetëm portieri i dytë i Burnleyt, do të jetë titullar

tek Ipswichi. Përmes një video të bukur, Ipswichi e prezantoi portierin e Kosovës. “Mirë se vjen te Town, Aro Muriq”, është thënë në mbishkrim.



Ekipi i xhudos niset drejt Parisit

PRISHTINË, 17 KORRIK - Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Akil Gjakova, Laura Fazliu dhe Loriana Kuka, bashkë me trajnerin Driton Kuka, trajneren dhe të artën Majlinda Kelmendi si dhe trajnerin Fatos Tabaku, të mërkurën janë nisur për në Lojërat Olimpikë Parisi 2024. Lajmin e ka dhënë Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK). Ekipit të xhudistëve shumë shpejt pritet t'i bashkohen

edhe sportistë të tjerë që do ta përfaqësojnë shtetin tonë. Lojërat Olimpikë Parisi-2024 do të mbahen nga data 26 korrik deri 11 gusht 2024 në Paris - Francë. Ekipi i Kosovës do të ndeshet nga data 27 korrik deri më 3 gusht. Në xhudo Kosova do të garojë me Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Akil Gjakova, Laura Fazliu dhe Loriana Kuka.

Boksiera Donjeta Sadiku do ta ketë një vend të ri për stërvitje

PRISHTINË, 17 KORRIK - Në objektin e hotelit “Grand” është bërë përrurimi i hapësirës së re për stërvitje profesionale të sportit të boksit për boksieren Donjeta Sadiku. Për të parë këtë mjedis të ri për ushtrime, gjithashtu për t'i uruar suksese në Lojërat Olimpikë Paris 2024,

Donjetën e ka vizituar kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendësministria e Sportit, Daulina Osmani. Kjo hapësirë tashmë është e gatshme për shfrytëzim falë bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Sportit me AKP-në dhe me Federatën e Boksit.

Në kuadër të kësaj ngjarjeje, boksiera Donjeta Sadiku i ka dhuruar kryeministrit një dorezë të boksit e cila është nënshkruar nga vetë ajo. Përveç xhudistëve, Donjeta Sadiku është e vetmja sportiste e vendit që është kualifikuar me normë olimpikë për pjesëmarrje në Lojërat Olimpikë Paris 2024.



Rrahmani: Napoli është favorit për ta fituar Scudetton

NAPOLI, 17 KORRIK - Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, ka thënë se Napoli është favoriti kryesor për ta fituar titullin e Serisë A. Napoli ka dështuar sezonin e kaluar duke mos arritur të sigurojë një vend në Evropë, mirëpo këtë verë ka marrë Antonio Conte trajner, me të cilin veçse ka nisur punën. Rrahmani, që pritet të jetë titullar te Conte, ka folur para tifozëve në Dimaro, ku ka deklaruar se janë favoritë për

titullin kampion. “Napoli është favorit për Scudetto. Pozita që do të luash? Te Verona kam luajtur si mbrojtës i djathtë, në vendet e tjera si qendërmbrojtës. Nuk është problem, luaj në çdo pozitë që më cakton trajneri. Jam më rehat në rastet kur luajmë si tre qendërmbrojtës. Koulibaly dhe Kim? Koulibaly ishte këtu për shumë kohë, ndërsa Kim vetëm për një vit, prandaj është vështirë t'i krahasosh këto dy çështje.

Conte? Fakti që Conte ka drejtuar klubet e mëdha tregon se çfarë trajneri i mirë është. Po bëjmë më shumë punë fizike, por mund ta shihni kualitetin e lojtarëve të rinj në ditët e para. E dimë se duhet të punojmë të gjithë fortë për t'u kthyer aty ku jemi”, ka thënë Rrahmani. Napoli do të ketë një përparësi me skuadrat e tjera italiane të cilat do të tentojnë ta tregojnë kualitetin edhe në garat evropiane.

Zyrtare: Luka Modric rinovon kontratën me Real Madridin

Madrid, 17 korrik - Mesfushori Luka Modric ka rinovuar kontratën me Real Madridin, që do ta mbajë atë edhe për një vit tjetër në

“Santiago Bernabeu”. Kroati, për dallim nga Toni Kroos, ka vendosur të vazhdojë edhe një tjetër vit me gjigantin madrilen,

pavarësisht se e di se do të jetë në stol shumicën e kohës. “Real Madridi dhe Luka Modric kanë arritur

marrëveshje për ta vazhduar kontratën e kapitenit tonë, i cili mbetet i lidhur me klubin deri më 30 qershor 2025”, ka njoftuar Real Madridi.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “STAR KIDS ACADEMY” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. UNIK: 811371559 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “STAR KIDS ACADEMY” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811371559 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “STAR KIDS ACADEMY” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811371559 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ben Islami shpall të humbur Çertifikaten e Regjistrimit për TVSH me numer serik: 3012613 si dhe numeri biznesi nr: 70104645

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 € euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

